

EC
MA NDYSHE



HULUMTIM
MJEDISI – PRIORITET
I LËNË ANASH
NGA KOMUNAT



MJEDISI – PRIORITET I LËNË ANASH NGA KOMUNAT

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Adresa: Rr. Fehmi Lladrovci 94,
Prizren, Bulevardi Nënë Tereza, H 30
B1 Nr.5, 10000 Prishtinë
Kontakti: www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është realizuar nga EC Ma Ndryshe financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, KFOS.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KFOS-it.



PËRMBAJTJA

1.0	HYRJE	1
-----	-------	---

2.0	METODOLOGJIA	2
-----	--------------	---

3.0	KOMPETENCAT	3
-----	-------------	---

4.0	GJENDJA E MJEDISIT NË KOSOVË	5
-----	------------------------------	---

5.0	GJETJET E HULUMTIMIT	9
-----	----------------------	---

6.0	KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET	18
-----	-------------------------------	----

7.0	PËR EC	20
-----	--------	----

Mjedisi si kategori kushtetuese në Republikën e Kosovës përkufizohet si përgjegjësi e secilit individ, përderisa institucionet e pushtetit publik kanë obligim t'u mundësojnë qytetarëve ndikimin në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin ku ata jetojnë. Ndërsa mbrojtja e mjedisit, pos tjerash, renditet si njëra prej vlerave në të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.¹

Kurse Ligji për mbrojtjen e mjedisit ka për qëllim promovimin e krijimit të mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht ligji synon harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit përkufizojnë se organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit janë Qeveria, Ministria dhe Komunat.²

Sipas praktikave të mira evropiane, që i ka përmendur Zyra Kombëtare e Auditimit, një sistem i qëndrueshëm, efikas dhe i integruar për mbrojtjen e mjedisit ekziston kur autoritetet publike bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo aktiviteti apo mase me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Praktikrat e këtilla kërkojnë monitorim të vazhdueshëm të të arriturave (objektivave) të veprimeve në mjedis. Monitorimi i mbrojtjes të mjedisit, rezulton me raportim të gjendjes mjedisore për ligjdhënësin dhe publikun.³

Por sipas raporteve të ndryshme të organizatave ndërkombëtare, por edhe atyre vendore, Kosova përballet me probleme të theksuara mjedisore, ndërkohë që mungesa e vullnetit politik të institucioneve shtetërore në ndërmarrjen e masave adekuate për mbrojtjen e mjedisit ka ndikuar në mirëqenien dhe shëndetin e qytetarëve.

Madje edhe Institucioni i Avokatit të Popullit përmes adresimeve publike ka vënë në spikamë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimin e tij në të drejtat e njeriut, duke i bërë thirrje të gjitha institucioneve për nevojën e renditjes së mjedisit në prioritet duke u fokusuar në veçanti në masa parandaluese dhe mënjuese, në mënyrë që të respektohet e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Sipas Avokatit të Popullit, përkundër obligimit kushtetues për mbrojtje të mjedisit, bazës së mjaftueshme ligjore, Kosova ende nuk ka arritur ta bëjë kthesën me të cilën do të zbeheshin ndërhyrjet arbitrare në ujë, ajër dhe tokë, me ç'rast ajri jociësor, uji i ndotur, shkarkimet e pakontrolluara, ndërhyrjet pa kriter në tokë, gurëthyesit dhe gurishtat, ndërtimet pa kriter jashtë parimeve të mirëfillta të ndërtimit dhe planifikimit hapësinor, dëmtimi i pyjeve, mosarritja e menaxhimit të duhur të mbeturinave, zhurma, mungesa e aktiviteteve rehabilituese etj. ka vazhduar me temp të njëjtë.⁴

Në fillim të vitit 2018, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52 dhe neni 7, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 1 dhe neni 5, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>

³ Raport i Auditimit "Qëndrueshmëria e masave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit", 2016, linku: <https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/Qendrueshmeria.e.masave.kombetare.per.mbrojtjen.e.mjedisit.761125.pdf>

⁴ Deklaratë e Avokatit të Popullit me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, 5 qershor 2021, linku: <https://oik-rks.org/2021/06/04/>

gjatë një tryeze me kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës ka diskutuar rreth identifikimit të obligimeve ligjore që i takojnë dy niveleve të qeverisjes, sikurse edhe për sfidat me të cilat ballafaqohen, me ç'rast drejtues të këtij dikasteri qeveritar patën theksuar se një pjesë e madhe e përgjegjësive për mjedisin dhe zbatimin e kornizës ligjore bien në domenin e komunave, dhe se është

koha që mjedisi të jetë prioritet i politikave lokale dhe qendrore.⁵

Mirëpo bazuar në monitorimin e EC Ma Ndryshe, mjedisi ende nuk zë vend në krye të listës së prioriteteve në nivelin lokal. Mjedisi ndonëse meriton të jetë ndër prioritetet kryesore shkaku i zhvillimeve të shumta degraduese vazhdon që të jetë i lënë anash nga komunat.

METODOLOGJIA 2.0

EC Ma Ndryshe ka hartuar metodologjinë për monitorimin dhe raportimin mjedisor si një mjet pune për raportimin rreth gjendjes mjedisore në Kosovë. Në kuadër të saj përfshihet edhe monitorimi i administratës lokale, ku adresohen përgjegjësitë e Komunave kundruall aspekteve kryesore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Metodologjia e EC-it për monitorim merr në konsideratë legjislacionin në fuqi që adreson aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunat e Kosovës. Disa nga komunat kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Për nevojat e këtij hulumtimi, EC Ma Ndryshe është përqendruar në aspektin e mbikëqyrjes inspektive dhe raportimit mjedisor, në 7 komunat e mëdha të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe

Mitrovicë e Jugut. Nga komunat përkatëse janë kërkuar informata dhe dokumente publike lidhur me shkallën e zbatimit të politikave lokale mjedisore si dhe për tejkallimet apo çrregullimet mjedisore të shkaktuara nga personat fizik dhe juridik. Të dhënat për këtë aspekt janë kërkuar për 6 mujorin e parë të vitit 2021, duke marrë për bazë faktin se viti i shkuar ka qenë vit zgjedhor për nivelin komunal, me ç'rast pjesa e dytë e vitit është dominuar nga fushata paraelektoale dhe zgjedhjet, që në disa komuna ka rezultuar edhe me ndryshimin e pushtetit. Informatat dhe dokumentet, që në sasi e cilësi kanë qenë të kufizuara, nga komunat përkatëse janë marrë kryesisht në formë elektronike, marrë parasysh edhe ndikimin e pandemisë Covid-19, me ç'rast nga data 20 gusht 2021 janë ashpërsuar masat anti-Covid. Informatat janë marrë edhe nga hulumtimi në ueb faqet zyrtare të 7 komunave, duke u fokusuar në Raportet e Punës të Drejtorive të Inspektorateve, Drejtoritë e Shërbimeve Publike e Drejtoritë e Mjedisit për periudhën gjashtëmujore (janar – qershor 2021) dhe raporteve njëvjeçare (janar – dhjetor 2020).

⁵ Mbrojtja e mjedisit, prioritet i komunave dhe i Qeverisë", KOHA, 24 janar 2018, linku: <https://www.koha.net/arberi/71334/mbrojtja-e-mjedisit-prioritet-i-komunave-dhe-i-qeverise/>

KOMPETENCAT PËR 3.0

MBROJTJEN E MJEDISIT

Organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit sipas Ligjit përkatës janë Qeveria, Ministria dhe Komunitatet.

Bazuar në nenin 5 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Qeveria miraton aktet nënligjore për implementimin e këtij ligji; për aplikimin e parimeve të mbrojtjes së mjedisit të përshkruara në nenin 6, dhe të bëjë përshtatjen e politikave të mbrojtjes së mjedisit me ato të BE-së, pastaj që të bëhen kufizimet, ndalimet dhe kontrollet tjera të emisioneve të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të liruara në mjedis nga ndotësit dhe mbeturinat nga instalime dhe projekte; të përcaktohen metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emisionet nga bazat e asfaltit, impiantet e gurëthyesve, nxjerrjeve të gurëve apo aktiviteteve tjera të nxjerrjes së gurëve, pikat e karburanteve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme; të bëhen kufizimet dhe ndalimet për emitimet nga makineria dhe pajisjet, për shfrytëzimin apo vendosjen në treg dhe për kërkesat e etiketimit; të bëhet trajtimi dhe përmbajtja e grumbujve të dheut-tokës së kontaminuar sipas standardeve teknike të trajtimit si dhe metodave të trajtimit dhe mbikëqyrjes; të përcaktohen metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emitimet nga bujqësia, ekonomia bujqësore e kafshëve, fermat e gëzofit, pylltaria dhe hurdhata e peshqve; të bëhet përcaktimi i mënyrës së pagesave për lejet mjedisore; të bëhet zvogëlimi i substancave që dëmtojnë shtresën e

ozonit; të bëhet zvogëlimi i substancave dhe aktiviteteve që ndikojnë në ndryshimin klimatik; të zbatohen kriteret dhe procedurat për shfrytëzim të instrumenteve për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, sipas nenit 7 të këtij ligji.

Ministria sipas këtij neni do të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë dhe rajon; do të miratojë akte nënligjore, udhëzime administrative, formularë, procedura të cilat janë në përgjegjësinë e tij sipas këtij ligji; angazhohet për zbatimin e masave dhe standardeve mjedisore për të stimuluar shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore; do të koordinojë përgatitjen dhe implementimin e politikave dhe instrumenteve mjedisore me ministritë tjera, komunitet, entitetet private, organizatat shkencore dhe profesionale, organizatat jo qeveritare dhe me qytetarët; do t'i propozojë qeverisë për miratim çmimoren për nxjerrjen e lejeve mjedisore, në bazë të nenit 31 të këtij ligji; do të bëjë propozimin e anëtarëve të Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit në Qeveri, i cili do të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; do të përcaktojë kriteret dhe procedurën për dhënien e mirënjohjeve; do të sigurojë shfrytëzim të drejtë të fondeve të dhëna nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore sipas politikave të qeverisë më qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu bënë përgatitjen e aplikimit të bashkë-financimeve të BE-së për projektet e investimeve në mjedis dhe implementimin e tyre.

Ndërkaq Komunat sipas ligjit bëjnë aplikim të plotë të parimeve të nenit 6; bashkëpunojnë me Ministrinë për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre sipas këtij ligji, zbatojnë ligjet dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre, përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm; planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës.

Ligji për Vetëqeverisjen lokale te kompetencat vetanake përkufizon se Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në disa fusha, në mesin e të cilave bën pjesë edhe mbrojtja e mjedisit lokal.

Ndërkaq Ligji për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, parasheh funksionimin e Inspektoratit si organ shtetëror në nivel lokal dhe qendror, i cili ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrjes inspektive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, natyrës, ujërave, urbanizmit dhe ndërtimit. Inspektorati i Ministrisë përbëhet nga: Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit; Inspektorati i mbrojtjes së natyrës; Inspektorati i ujërave; Inspektorati i planifikimit hapësinor dhe urbanistik; Inspektorati i ndërtimit. Ndërsa organizimi i Inspektoratit në nivel lokal parasheh organizimin në kuadër të drejtorive komunale sipas fushave përkatëse: Inspektorati komunal i mbrojtjes së mjedisit, dhe Inspektorati komunal i ndërtimit.

Inspektorati komunal i mbrojtjes së mjedisit ushtron detyrat dhe përgjegjësitë përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe natyrës, dhe se sipas legjislacionit duhet të realizojë mbikëqyrjen në zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara me lejet komunale mjedisore, lejet ujore dhe të mbrojtjes së natyrës, të lëshuara nga Komuna.

Në një analizë të mëhershme të bërë nga Instituti GAP lidhur me kompetencat vetanake të komunave, theksohet se edhe mbrojtja e mjedisit është fushë e cila i lihet në kompetencë komunave, por që në praktikë, kompetencat më të mëdha në këtë fushë i takojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe se shumica nga komunat nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga ligjet në këtë fushë.⁶

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i publikuar në vitin 2021 thekson se legjislacioni për inspektimet mjedisore nuk është miratuar dhe se mungojnë kapacitetet e inspektoratit për zbatim.⁷

Kuvendi i Kosovës në fund të dhjetorit të vitit 2021 ka miratuar në lexim të dytë Ligjin për Inspektimet.⁸ Mirëpo, kapitujt: III – Organet inspektuese, V – Statusi dhe trajnimi i inspektorëve; VIII – Format themelore të Inspektimit, IX – Procedura e inspektimit dhe Shtojca (Lista e inspektorateve qendrore dhe njësisive të veçanta inspektuese) e këtij ligji parashihet të hyjnë në fuqi 18 muaj pas botimit të këtij ligji në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

⁶ "Sa kanë kompetenca vetanake komunat?", Analizë, 2017, linku: https://www.institutigap.org/documents/94817_Gap%20Analiz%C3%AB%205%20kompetencat.pdf

⁷ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i publikuar në vitin 2021, linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

⁸ Linku: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/kuvendi-miratoi-ne-lexim-te-dyte-projektligji-28631/>

GJENDJA E MJEDISIT 4.0 NË KOSOVË

Ministri i MMPHI-së në nëntor të vitit 2021, në Kuvendin e Kosovës, gjatë shqyrtimit të raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2020, ka theksuar se nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë. Ai ka pohuar se çështja e mjedisit në Kosovë trajtohet me prioritet të ulët, dhe ka shprehur zotimin se do të ketë ndryshim në këtë fushë ashtu që çështjet mjedisore do të marrin vëmendjen e duhur. Sipas tij, janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisore, si në nivelin qendror, dhe atë lokal. Por ka shtuar se niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm, dhe se mbetet sfidë që të thellohet ky zbatim i ligjit, ku gjatë vitit 2020 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës e në aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjediset, që megjithatë vazhdojnë të jenë në numër shqetësues. Gjatë prezantimit të raportit në fjalë, pos tjerash, ai ka bërë të ditur se është konstatuar implementim në nivel të ulët të ligjeve, akteve nënligjore dhe i politikave për sektorin e ajrit, pastaj se cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja që vjen si rezultat i aktiviteteve të ndryshme, se Kosova nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut, sikurse që përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës,

derisa të menaxhimi i mbeturinave ka thënë se Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas, njëjtë sikurse që menaxhimi i deponive sanitare në Kosovë nuk është i duhuri, etj.⁹

Edhe Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i publikuar në vitin 2021 thekson se Kosova duhet ta rrisë angazhimin e saj politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat ndaj ndryshimeve klimatike, në mënyrë që të harmonizohet me Agjendën e Gjelbër dhe qëllimet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë raport kërkohet që në vitin 2022, Kosova të ndërmer masa për të zvogëluar ndotjen e ajrit e ujërave, të rrisë mbulueshmërinë e grumbullimit të mbeturinave, si dhe ndarjen e riciklimin, pastaj zbatimin e dispozitave ligjore mbi përgjegjësinë, dëmtimet e krimet mjedisore, të zbatohet parimi ndotësi paguan, si dhe të zbatohet strategjia e plani i veprimit për ndryshimet klimatike.¹⁰

Gjetjet e publikuara nga institucionet vendore përgjegjëse për mjedisin tregojnë se duhet angazhim shtesë për përmirësimin e gjendjes aktuale, përkatësisht parandalimin e evitimin e dëmtimit dhe degradimit të mjedisit.

⁹ Fjalimi i ministrit të MMPHI-së në seancën e Kuvendit të Kosovës, linku: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2021_11_18_ts_Seanca_dME99G8GR8.pdf

¹⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i publikuar në vitin 2021, linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

AJRI 4.1

Burimet ndotëse kryesore të ajrit në territorin e Kosovës janë termo-centralet Kosova A dhe Kosova B, djegiet e vogla (ekonomitë familjare, furrat e bukës, restaurantet, etj.), operatorët industrial dhe operatorët tjerë ekonomik (bizneset); transporti rrugor, deponitë e mbeturinave urbane, bujqësia, gurëthyesit. Stinët vjeshtë-dimër rezultojnë me ndotje më të lartë në krahasim me stinët tjera të vitit. Niveli i ngritur i vlerave të ndotësve në ajër është si rezultat djegieve nga industria, djegiet e lëndës fosile për djegie nga ekonomitë familjare, transporti, etj. Në këtë periudhë, kushtet meteorologjike ndikojnë shumë në cilësinë e ajrit për shkak të lagështisë së ajrit, të reshurave atmosferike, mjegullës, etj. Parametrat me vlera me të larta në ajër të cilët janë monitoruar nga stacionet monitoruese janë vlerësuar së janë grimca e pluhurit PM10/PM2.5. Sipas AMMK¹¹ emetimet më të mëdha me PM10 dhe

PM2.5 vijnë nga sektori i djegieve të vogla dhe industria. Emetimet më të mëdha për RNX vijnë nga sektori i industrisë dhe të transportit, ndërsa emetimet më të madh për ES02 vijnë nga industria. Emetimet vjetore të gazrave serë në Kosovë janë vlerësuar rreth 9,613 gigagramë dhe të dioksidit të karbonit ekuivalon rreth 9,6 tonë. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serë është sektori i energjisë me pjesëmarrje 86% të totalit të emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 8% dhe sektori i mbeturinave përfaqëson 5% të totalit të emisioneve. Është konstatuar po ashtu se implementimi në nivel të ulët të ligjeve, akteve nënligjore dhe i politikave për sektorin e ajrit, sikurse edhe rasti i politikave për kontroll në emisionet nga burimet e lëvizshme dhe atyre për kontrollin e cilësisë së naftës.

UJI 4.2

Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë, sipas raportit të AMMK¹² vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimet e pesticideve dhe fertilizereve në bujqësi si dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve dhe ndërtimet ilegale. Treguesit e prezantuar në raportin për gjendjen e mjedisit në vitin 2020 tregojnë për prani të ndotësve organikë në ujëra të lumenjve, megjithëse mund të konstatohet që ujërat sipër-

faqësore nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi në përgjithësi. Kosova ende nuk ka të zhvilluar sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura, meqenëse ndodhet në fazën e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Tashmë ka përfunduar ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Prizrenit. Ndërsa që impiantet e tjera janë në fazën e studime të fizibilitetit dhe të realizimit të punimeve. Aktualisht impiantet funksionale për

¹¹ Fjalimi i ministrit të MMPHI-së në seancën e Kuvendit të Kosovës, linku: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2021_11_18_ts_Seanca_dME99G8GR8.pdf

¹² Po aty

trajtim të ujërave të zeza, të ndotura, të zeza dhe të ndotura, janë impiantet e trajtimit në Skenderaj me kapacitet vjetor prej 734 e 421 metër kub, si dhe

dy impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura në Halilaq, Badoc, me kapacitet më të vogël.

Kosova nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulueshmërisë së tokave, është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. AMMK¹³ ka konstatuar se ka rritje të sipërfaqeve të zonave urbane, zonave industriale e komerciale dhe atyre për nxjerrjen e mineraleve, kurse ka pasur humbje të sipërfaqeve për kategoritë e tokave bujqësore, kullosave dhe

Regjistri kombëtar i zonave të mbrojtura sipas AMMK¹⁴ është shtuar në shtatë zona të reja, duke rritur numrin e zonave të mbrojtur në 217 me një sipërfaqe prej 125 816 hektarë ose 11,53% e territorit të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës. Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes, e të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse. Problem vlerësohet të jetë edhe mungesa e planeve hapësinore

pyjeve. Ndërsa sipërfaqet e zonave të gjelbra dhe atyre rekreative kanë mbetur të njëjta. Bujqësia konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokave bujqësore që vjen si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kemikateve të tjera për trajtimin e tokave. Po ashtu edhe industritë aktive, edhe ato të vjetra, janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kemikateve që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

TOKA 4.3

ZONAT E MBROJTURA 4.4

menaxhuese dhe rregulluese për disa nga këto zona. Nga monitorimi i faunës përmes kamerave e kurtheve janë marrë informacione për praninë e shumë llojeve të rralla e të rrezikuara të faunës në Kosovë. Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit, në përgjithësi, apo llojeve të veçanta, në veçanti. Konsiderohen si pozitive dhe me rëndësi zbatimi i disa iniciativave dhe projekteve për menaxhimin ndërkufitar të zonave natyrore.

¹³ Pa aty

¹⁴ Pa aty

MENAXHIMI I 4.5 MBETURINAVE

Kosova sipas raportit të AMMK¹⁵ vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori është vlerësuar në 230.85 kilogramë për banor brenda vitit. Aktualisht në nivel nacional grumbullohet rreth 84% e mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohet në deponi sanitare, ndërsa që ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes në burim dhe riciklimin të mbeturinave. Menaxhimi i deponive sanitare në Kosovë nuk është i duhur dhe ndër problemet kryesore janë mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara dhe mbulimi jo i mjaftueshëm i mbeturinave. Është evidentuar po ashtu

edhe numër i madh i deponive ilegale në tërë territorin e Kosovës, edhe pse ka pasur progres për shkak se kemi rënie të numrit të deponive, pra nga 1489 sosh në vitin 2019, në 1189 sosh në vitin 2020. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm të institucioneve qendrore, komunave dhe donatorëve deponitë ilegale vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori. Aktivitetet për ndarjen në burim, trajtimin e mbeturinave, riciklimin e mbeturinave dhe aspekte të tjera që ndërlidhen me ekonominë qarkore ende janë në shkallë të ulët. Krahasuar me vitin 2019, gjatë vitit 2020 ka pasur gjenerim më të madh të mbeturinave spitalore që kanë ardhur si rezultat i përballjes me pandeminë COVID-19.

SHFRYTËZIMI I RESURSEVE 4.6 NATYRORE

Shfrytëzimi i gurit dhe i resurseve të tjera minerare që realizohen përmes gurthyesve, është një nga format më të shpeshta të shfrytëzimit të resurseve natyrore në Kosovë, gjatë vitit 2020 janë lëshuar 228 licenca për shfrytëzim të gurit dhe 204 licenca për hulumtime të rezervave të gurit.¹⁶ Të dhënat flasin se ka edhe operatorë ilegale që merren me këtë veprimtari. Vlerësohet se gjatë vitit 2020, sipas planifikimit janë shfrytëzuar 157 mijë e

970,95 metra kub masë drunore nga pyjet e Kosovës nga sektori privat dhe ai publik. Në këtë vlerësim nuk janë përfshirë prerjet ilegale të pyjeve. Kurse sa i përket ujit, sasia më e madhe shfrytëzohet për pije, si dhe nga sektori i amvisërisë, sektori i industrisë dhe ai i ujitjes së tokave.

¹⁵ Po aty

¹⁶ Po aty

SHËNDETI 4.7 PUBLIK

Numri i sëmundjeve ambientale të regjistruara vazhdon të ketë një trend linear në Kosovë. Në disa raste është regjistruar një ngritje e ndjeshme numrit të disa sëmundjeve që ndërlidhen me aspektin mjedisor. Gjatë vitit 2020 duhet të veçohet numri i madh i të sëmurëve me COVID-19. Megjithëkëtë në Kosovë ende nuk ka një studim të detajuar dhe të bazuar në tregues që do të vlerësonte ndikimin real të gjendjes në mjedis në shëndetin publik. Sipas të dhënave statistikore, mbi shkaqet e vdekjeve në Kosovë konstatohet se numri më i madh i vdekjeve sa u përket shkaqeve që

ndërlidhen me mjedisin janë ato nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, tumoret e nga sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes. Moshë mesatare e të vdekurve në Kosovë vlerësohet të jetë 73,1 vjet. Kontrolli i ujit të pijshëm tregon se rreth 99,4% e testeve kanë qenë në përputhshmëri me standardet vendore të cilësisë së ujit.¹⁷

GJETJET KRYESORE TË 5.0 HULUMTIMIT

Lidhur me mbikëqyrjen inspektive dhe raportimin mjedisor, EC nga 7 komunat e mëdha të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë e Jugut, ka kërkuar të dhëna lidhur me shkallën e zbatimit të politikave lokale mjedisore si dhe për tejkalmimet apo çrregullimet mjedisore të shkaktuara nga personat fizik dhe juridik. Në komunat përkatëse janë përcjellë kërkesat për marrjen e informatave lidhur me inspektimin e zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit si dhe hartimin e raporteve përkatëse; nëse përpilohen raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore; nëse monitorohet në mënyrë sistematike gjendja e deponive të mbeturinave; nëse ka vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis; nëse monitorohet gjendja e zonave të

mbrojtura; nëse monitorohet gjendja e pyjeve, përfshirë edhe gjendja shëndetësore e tyre; nëse janë identifikuar çrregullime mjedisore nga aktivitetet e personave fizik ose juridik dhe nëse janë identifikuar raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara.

Nga përgjigjet e marra rezulton se numri i inspektorëve mjedisorë në komunat përkatëse është simbolik. Ky numër i inspektorëve mjedisorë nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar territoret e komunave të mëdha, e aq më pak të ketë ndonjë ndikim domethënës në parandalimin dhe evitimin e ndotjes së mjedisit.

¹⁷ Po aty

Komuna e Prizrenit ka raportuar se inspektimi i kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit bëhet nga MMPHI-ja, sikurse edhe raportimi. Sipas tyre edhe strategjitë mjedisore janë përgjegjësi e nivelit qendror, derisa te niveli lokal të dhënat për këto çështje janë të pakta. Sektori i mjedisit në Prizren ka pohuar se monitoron deponinë sanitare në Landovicë dhe atë të inerteve në rrugën Zhur-Drash, dhe se vlerësimet e ndikimit në mjedis bëhen nga personat e autorizuar nga ministria. Sa i përket zonave të mbrojtura është theksuar se ato monitorohen pjesërisht pasi këto zona monitorohen nga zyrtarët përgjegjës të ministrisë. Për pyjet është thënë se ato monitorohen nga Agjencia e Pyjeve, dhe se në nivel lokal përgjegjësia është te Drejtoria e Bujqësisë. Lidhur me identifikimin e

çrregullimeve mjedisore, Komuna e Prizrenit është përgjigjur se: “çrregullime të mëdha nuk ka pasur, por edhe nëse ka pasur, niveli lokal nuk ka aparatura apo instrumente për matjen e parametrave të cilët i kanë tejkaluar normat ligjore (MMPH)”. Për rastet eventuale të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara, Prizreni ka theksuar se ka asistuar inspektoratin mjedisor të MMPHI-së, sa herë që ka pasur nevojë. Komuna e Prizrenit ka vetëm 1 inspektor mjedisor, dhe gjatë periudhës janar-qershor 2021 ai ka hartuar 20 aktvendime, 7 kërkesa për gjykatë dhe 1 gjobë mandatore. Ndërsa në periudhën korrik-dhjetor 2021, inspektori mjedisor ka hartuar 5 aktvendime, 1 kërkesë për Gjykatë për kundërvajtje dhe ka shqiptuar 1 gjobë mandatore sipas UA 06/2018.

Komuna e Gjilanit ka raportuar se nuk ka zhvilluar inspektim për zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit, dhe as raportim për këtë çështje. Sa i përket monitorimit sistematik të gjendjes së deponive të mbeturinave, kjo komunë ka bërë të ditur se në vazhden e aktiviteteve realizon inspektime të kohëpas-kohshme të funksionimit të deponive aktuale në Komunën e Gjilanit. Për monitorimin e gjendjes së zonave të mbrojtura përgjigja ka qenë se për disa prej tyre realizohen monitorime. Për pyjet është thënë se nuk ka pasur inspektime sa i përket gjendjes së pyjeve e as kontrolle lidhur me

gjendjen e tyre. Rastet e eksploatimit të resurseve natyrore sipas kësaj komune janë inspektuar në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Gjilani në periudhën janar-qershor 2021 ka nxjerrë 1 aktvendim, ka adresuar 1 kërkesë për gjykatë dhe ka shqiptuar 10 gjoba mandatore. Ndërsa në periudhën korrik-dhjetor 2021 nga Inspektorati për mbrojtje të mjedisit janë shqiptuar 4 gjoba mandatore sipas legjislacionit në fuqi, derisa 1 kërkesë është adresuar në Gjykatë, për mbylljen e pikës grumbulluese për mbeturina shkak i mos pajisjes me Leje Mjedisore Komunale.

Komuna e Mitrovicës së Jugut ka bërë të ditur se nuk ka fare inspektorë mjedisorë dhe se nuk bën inspektim të rregullt të zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit. Në rastet e caktuara inspektimi në fushën e mjedisit kryhet nga inspektorët e sektorëve tjerë në bazë të autorizimit nga organet komunale. Mirëpo në përgjithësi zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit konsiderohet si përgjegjësi e MMPHI-së. Komuna ka theksuar se drejtorja e saj e mjedisit raporton në baza të rregullta në AMMK dhe në Kuvendin e Komunës. Lidhur me monitorimin e gjendjes së deponive të mbeturinave, kjo komunë ka pohuar se bashkë me akterët tjerë evidenton deponitë ilegale. Ndërsa për vlerësimin e ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis kjo komunë ka pohuar se nuk ka ndonjë vlerësim të veçantë, por se këtë çështje e trajton në kuadër të Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2021-2025. Për monitorimin e gjendjes së zonave të mbrojtura është thënë se ato monitorohen nga organet e ministrisë, në bashkëpunim me inspeksionin komunal. Sa i përket gjendjes së pyjeve, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka theksuar se monitorimi realizohet

sipas kompetencave që ka autoriteti pyjor komunal në kuadër të Drejtorisë së Mjedisit, që ka kompetenca për mbrojtjen nga dëmtimet, prerjet ilegale, dhënie në shfrytëzim, pyllëzim, etj. Ndërsa vlerësimi shëndetësor i tyre sipas komunës është përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë.

Komuna ka pohuar se janë identifikuar çrregullime mjedisore nga aktivitete të personave fizik ose juridik dhe atë kryesisht tek prerja e pyjeve, drunjve në zonat urbane, hedhja e mbeturinave në brigjet e lumenjve dhe në shtratin e tyre, krijimi i deponive ilegale, etj. Ndërsa për rastet e tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara është thënë se është përgjegjësi e MMPHI-së, dhe se në raste specifike inspektorët komunal kanë asistuar kolegët nga niveli qendror. Inspektorët komunal të kësaj komune në periudhën janar-qershor kanë përpiluar 22 fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 11 fletëparaqitje penale. Ndërkaq në periudhën korrik-dhjetor 2021, kjo komunë ka shqiptuar 2 gjoba mandatore sipas UA 06/2018, dhe 2 gjoba tjera për hapësirat publike.

Komuna e Pejës sa i përket inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit ka pohuar se për çdo vit raportohet në performancën komunale mbi zbatimin e Planit Lokal të Veprimtimit në Mjedis, ndonëse ky plan në këtë komunë ka skaduar qysh në vitin 2015. Sipas kësaj komune nuk hartohen raporte të inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore, e as ato rreth zbatimit të strategjive mjedisore. Kjo komunë ka theksuar se zyrtari për menaxhimin e mbeturinave në kuadër

të DSHP-së, sikurse edhe inspektorët e mjedisit monitorojnë gjendjen e deponive të mbeturinave, dhe se deri më tani është bërë Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për zgjerimin e deponisë rajonale në Sferkë. Peja ka bërë të ditur se gjendja e zonave të mbrojtura monitorohet nga niveli qendror, derisa për monitorimin e gjendjes së pyjeve është thënë se një gjë e tillë realizohet nga Agjencia Pyjore, zyra rajonale në Pejë e drejtorja e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna.

Në të njëjtën kohë, Peja nuk ka raporte lidhur me identifikimin e çrregullimeve mjedisore nga aktivitete të personave fizik ose juridik. Numri i inspektorëve komunal të mjedisit në këtë komunë është 2, dhe gjatë periudhës janar-

qershor 2021 janë shqiptuar 19 gjoba mandatore. Ndërsa në periudhën korrik-dhjetor 2021 janë shqiptuar gjithsejtë 25 gjoba mandatore me vlerë totale 9,500 €, derisa në gjykatë nuk është dërguar asnjë kërkesë.

Komuna e Gjakovës në përgjigjen e saj ka theksuar se inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit realizohet brenda mundësive, pasi që kjo komunë ka vetëm një Inspektor të Mbrojtjes së Mjedisit. Raportet e inspektimit që janë javore e mujore sipas kësaj komune dorëzohen në Drejtorinë për Punë Inspektuese. Sa i përket raporteve të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore përkatësisht raportet mjedisore në nivelin lokal, Gjakova ka pohuar se hartohen vetëm disa prej tyre, si p.sh.: Raporti i zbatimit të Planit të Menaxhimit të mbeturinave. Gjendja e deponive të mbeturinave sipas kësaj komune monitorohet, derisa nuk janë zhvilluar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis. Kjo komunë ka bërë të ditur se gjendja e zonave të mbrojtura monitorohet, derisa për monitorimin e

gjendjes së pyjeve, është thënë se kjo është më tepër kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjakova ka pranuar se janë identifikuar çrregullime mjedisore nga aktivitete të personave fizik ose juridik, sikurse dëmtimi i lumenjve nga eksploatimi i zhavorrit, dëmtimi i mjedisit nga eksploatimi i rërës kuarcore, etj., dhe se janë identifikuar raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara, me ç'rast është shqiptuar një gjobë mandatore. Në periudhën janar – qershor 2021, janë shqiptuar 19 gjoba mandatore nga inspektori mjedisor. Ndërsa në periudhën korrik-dhjetor 2021 inspektori për mbrojtje të mjedisit ka shqiptuar 4 gjoba sipas UA 06/2018, si dhe 3 gjoba tjera me vendime në vlera nga 500 €, 400 € dhe 200 €, derisa nuk ka asnjë kërkesë të adresuar në Gjykatë.

Komuna e Prishtinës në përgjigjen e pjesshme ka theksuar se nga pyetjet e parashtruara vetëm një nga to bën pjesë në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, derisa shumica tjetër janë në kompetencë të Drejtorisë së Inspektoratit, e të cilat kanë mbetur pa përgjigje. DSHPMSh-ja ka njoftuar se bënë monitorimin e deponive ilegale së paku në baza vjetore, kur edhe

regjistrohen, dhe si rezultat hartohet edhe raporti që dorëzohet në AMMK, e cila harton raportin për gjendjen e mbeturinave në Republikën e Kosovës. Monitorimi i vazhdueshëm sipas përgjigjes së Komunës së Prishtinës bëhet nga Drejtoria e Inspektoratit derisa drejtori tjetër relevante është edhe Drejtoria e Planifikimit – sektori i Mjedisit. Komuna e Prishtinës ka bërë të ditur se nuk ka fare inspektorë

mjedisorë, porse inspektimi në fushën e mjedisit kryhet nga inspektorët e sektorit të pylltarisë në bazë të autorizimit të veçantë. Gjatë periudhës janar-qershor 2021 kjo Komunë ka lëshuar 11 fletëparaqitje për kundërvajtje, 12 fletëparaqitje penale, ka regjistruar 7 dëmtime të hapësirave publike të gjelbëruara dhe 8 raste të

hedhjes së dheut e mbeturinave. Ndërsa për periudhën korrik-dhjetor 2021, Komuna e Prishtinës ka bërë të ditur se janë shqiptuar 21 gjoba mandatore për ndotje të ambientit, dhe se nuk ka aktvendime të Inspektoratit komunal dhe as kërkesa të adresuara në Gjykatë, pasi që nuk ka Inspektorë të mjedisit.

Komuna e Ferizajt për çështjet e mësipërme nuk ka ofruar informata. Kjo komunë prej shkurtit të vitit 2018 ka 2 inspektorë mjedisorë, dhe gjatë periudhës janar-qershor 2021 janë shqiptuar gjithsejtë 186 gjoba menda-

tore. Ndërkaq në periudhën korrik-dhjetor 2021 janë shqiptuar gjithsejtë 20 gjoba mandatore sipas UA 06/2018, derisa në Gjykatë nuk është adresuar asnjë kërkesë.

KOMUNAT NUK I DËRGOJNË NË MMPHI DHE NUK I PUBLIKOJNË RAPORTET VJETORE TË MBIKËQYRJEVE INSPEKTUESE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT 5.1

Ligji për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit ka për qëllim në mes tjerash organizimin dhe mbikëqyrjen inspektuese, sikurse edhe koordinimin e mbikëqyrjes inspektuese, dhe çështje tjera me rëndësi në këtë aspekt. Mirëpo ky bashkërendim ende nuk është në nivelin e duhur, ndërmjet inspektoratit të nivelit lokal dhe atij qendror, pasi që për çështjet mjedisore niveli lokal nuk i raporton Inspektoratit të Ministrisë përmes raporteve vjetore, ani pse një gjë e tillë është obligim ligjor.

Mbikëqyrja inspektuese sipas legjislacionit nënkupton kontrollin dhe

mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit dhe akteve tjera ligjore, sikurse edhe zbatimin e masave administrative dhe masave tjera ndaj aktiviteteve punuese, personave fizikë dhe juridikë me qëllim të parandalimit, zvogëlimit dhe mënjanimin të parregullsive në zbatimin e ligjit dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Në bazë të Ligjit për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit organizimi i inspektoratit në nivel lokal në kuadër të drejtorive komunale realizohet sipas fushave përkatëse: Inspektorati komunal i mbrojtjes së mjedisit, dhe Inspektorati komunal i ndërtimit, ku

caktimi i numrit të inspektorëve rregullohet nga organi i pushtetit lokal, ku po ashtu inspektorët komunal udhëheqin evidencën e mbikëqyrjeve inspektuese dhe janë të obliguara t'i raportojnë Inspektoratit të Ministrisë përmes raporteve vjetore në fushat përkatëse.

Mirëpo sipas deklarimeve të zyrtarëve përgjegjës të MMPHI-së nuk ka raportime të rregullta nga inspektorati

i nivelit lokal, ani pse këta të fundit do të duhej që në fund të vitit ta njoftojnë Inspektoratin e Ministrisë rreth punës së realizuar, me qëllim që kjo të shërbejë edhe për bashkërendimin e aktiviteteve të linjës së njëjtë. Sipas tyre inspektorët e nivelit lokal përmbushin obligimet e tyre sipas legjislacionit sa i përket rasteve të veçanta dhe sipas kërkesës së Inspektoratit të Ministrisë, me ç'rast raportojnë sipas kërkesës së caktuar.

TRANSPARENCA E ULËT E KOMUNAVE 5.2

PËR MBIKËQYRJEN INSPEKTIVE DHE RAPORTIMIN MJEDISOR

Transparenca e organeve komunale lidhur me mbikëqyrjen inspektive dhe raportimin mjedisor është në nivel të ulët. Komunat e mëdha të Kosovës, si: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani, Ferizaj dhe Mitrovica e Jugut shpalosin shumë pak informata për publikun sa i përket shkallës së zbatimit të politikave lokale mjedisore sikurse edhe për tejkalimet apo çrregullimet mjedisore të shkaktuara nga personat fizik apo juridik.

Të dhënat e nivelit komunal rreth: inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit; monitorimit të gjendjes së deponive të mbeturinave; monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura; monitorimit të gjendjes së pyjeve, si dhe identifikimit të çrregullimeve mjedisore nga

aktivitete të personave fizik ose juridik, sikurse edhe ato për aktvendimet; kërkesat për gjykatë dhe gjobat mandatore të shqiptuara, nuk shpalosen në tërësi e as rregullisht, gjë që kufizon të drejtën e publikut për të pasur një pasqyrë të qartë dhe objektive lidhur me gjendjen e mjedisit dhe veprimet e ndërmarra për mbrojtjen e tij.

Në këtë aspekt, edhe informatat e ofruara nga komunat, konfirmojnë edhe njëherë se mjedisi nuk renditet lartë në prioritetet e politikave publike të komunave, të cilat çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin më tepër i trajtojnë si kompetenca vetëm të nivelit qendror respektivisht të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

KOMUNAT NUK I KANË HARTUAR PLANET LOKALE TË VEPRIMIT PËR CILËSINË E AJRIT

Legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e ajrit nga ndotja parasheh që edhe pushteti lokal të hartojë Planin e veprimit për cilësinë e ajrit. Por deri më tani shumë pak komuna në Kosovë e kanë hartuar këtë politikë publike. Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – qershor 2021 i publikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bënë të ditur se vetëm njëra nga 38 komunat ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit. “Hartimi i Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit mbetet sfidë e theksuar e komunave ku vetëm 1 komunë (Gllogoc) ka hartuar këtë plan”, thuhet në këtë raport.¹⁸

Sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (Nr. 03/L-160), komunat e kanë për detyrë hartimin e këtyre planeve sikurse edhe raportimin për zbatimin e tyre. Në nenin 31, të këtij ligji, thuhet se planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit definojnë politikën, menaxhimin e cilësisë së ajrit për periudhën pesë vjeçare dhe veprimet përbrenda territorit të komunës, në harmoni me Strategjinë e cilësisë së ajrit. Gjithashtu shkruan se këto plane janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis. “Raporti për zbatimin e planit shqyrtohet nga Kuvendet e Komunave”, thuhet në paragrafin 3 të këtij neni.

GJENDJE E PALAKMUESHME NË DEPONITË SANITARE TË KOSOVËS

Gjendja në deponitë sanitare të Kosovës mbetet e palakmueshme, bazuar në vlerësimet e bëra dhe raportet e hartuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Sipas konstatimeve të kësaj Agjencie, ajo vjen duke u rënduar si pasojë e keqmenaxhimit, mos investimeve rehabilituese, por edhe nga tejkalimi i kapaciteteve të pranimit të masës së mbeturinave.

Një raport i AMMK-së i publikuar në qershor të vitit 2021 ka bërë të ditur se gjatë periudhës shkurt-qershor 2021,

është bërë monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së deponisë sanitare të mbeturinave komunale për regjionin e Pejës, deponisë sanitare të mbeturinave komunale për regjionin e Prizrenit dhe stacionit për transferimin e mbeturinave komunale në Gjakovë. “Bazuar në vizitat e realizuara në këto deponi është konstatuar që gjendja e tyre nuk është e mirë dhe se ka probleme që ndërlidhen me menaxhimin e deponive”, thuhet në publikimin e AMMK-së, me ç’rast theksohet se ndër problemet kryesore të evidentuara janë ngjeshja dhe

¹⁸ Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – qershor 2021, linku: <https://mapl.rks-gov-.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/>

mbulimi jo i rregullt i mbeturinave, shpërndarja jo e rregullt e mbeturinave në deponi, mbeturinat jashtë rrethojave të deponisë, shkarkimi i ujërave të deponisë jashtë basenit të grumbullimit, prania e qenve endacak në zonën e deponisë si dhe prania e individëve të pa autorizuar në deponi që merren me grumbullimin e llojeve të caktuara të mbeturinave me qëllim shitjen e tyre.¹⁹

Ndërkaq në Raportin e Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë për vitin raportues 2019, të publikuar gjatë vitit 2021, AMMK duke u bazuar në të dhënat e siguruara, ku përfshihet i gjithë cikli i mbeturinave, duke filluar nga prodhimi e deri tek trajtimi përfundimtar i tyre, ka konstatuar se vërehet një lëvizje në përmirësim të

treguesve. Por aty ceket se problematikë e madhe në nivel vendi ende vazhdon të mbetet deponimi i pjesës dërmuese të mbeturinave të gjeneruara në deponitë sanitare. Gjithashtu veçohet gjendja e rëndë në deponitë sanitare. "Edhe këtë vit raportues është regjistruar një gjendje e rëndë e deponive sanitare në Kosovë, e cila vjen duke u rënduar si pasojë e keqmenaxhimit, mos investimeve rehabilituese, por edhe nga tejkalimi i kapaciteteve të pranimit të masës së mbeturinave", thuhet në raport. Në të njëjtën kohë theksohet se ende nuk ka iniciativa të mirëfillta qoftë në nivel lokal apo në nivel vendi, që tregojnë veprime konkrete drejt një ekonomie qarkore, derisa edhe riciklimi mbetet ende një sfidë e vështirë që të realizohet.²⁰

MBETURINAT DEPONOHEN PA 5.5 NDONJË NDARJE

Sfidat e menaxhimit të sasive në rritje të mbeturinave, veçanërisht nga zonat urbane në zgjerim, paraqesin një kosto të konsiderueshme për shoqërinë si dhe ushtrojnë presion mbi mjedisin natyror dhe ndryshimet klimatike. Por ky material i hedhur po ashtu përfaqëson një burim të vlefshëm, i cili mund të ruhet në ekonomi duke përqafuar qasjen e ekonomisë qarkore. Për një ekonomi qarkore është thelbësore që të riciklohen materialet nga mbeturinat. Një rol të rëndësishëm luan edhe rikuperimi i energjisë nga mbeturinat. Bashkimi Evropian i ka dhënë prioritet politikave të ekonomisë qarkore.

Prandaj është e përkushtuar për zbatimin e parimeve të hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave, e cila

promovon parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre. Kjo kërkon zhvillimin dhe vendosjen e zgjidhjeve eko-inovative.

Ndërkohë për institucionet e Kosovës, të nivelit lokal e atij qendror menaxhimi i mbeturinave mbetet sfidë serioze, pasi që akoma nuk janë gjetur përgjigjet e duhura, sa i përket grumbullimit, transportit, riciklimit, ripërpunimit dhe deponimit të tyre, duke paraqitur rrezik potencial për mjedisin e rrjedhimisht edhe për shëndetin e njeriut.

Gjetjet e fundit të Zyrës Kombëtare të Auditimit tregojnë se mbeturinat në

¹⁹ Raport, Vlerësimi i gjendjes mjedisore të Deponisë sanitare në Pejë, Deponisë sanitare në Prizren dhe Stacionit për transferim të mbeturinave në Gjakovë, linku: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_deponite_sanitare_062021.pdf

²⁰ Raporti i Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë për vitin raportues 2019, linku: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_mbeturinave_komunale_2019_ALB_version.pdf

Kosovë deponohen pa ndonjë ndarje duke përfunduar të gjitha në një vend. ZKA ka publikuar raportin e auditimit të performancës me temën “Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale”, për të vlerësuar nëse institucionet përgjegjëse janë duke bërë mbledhjen, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave komerciale në mënyrë efektive me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve që ndikojnë në mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve, ku subjekt i auditimit kanë qenë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” dhe “Pastërtia”, Komuna e Ferizajt dhe e Fushë Kosovës si dhe Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë. “Konkluzioni i auditimit është se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, komuna e Ferizajt dhe Fushë Kosovës nuk kanë arritur të krijojnë kushte për ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave. Për pasojë rrezikohet mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut”, thuhet në raport, duke shtuar se Ministria nuk ka hartuar politika dhe procedura për mënyrën e menaxhimit të të gjitha llojeve të mbeturinave. Aty përkujtohet se për menaxhimin e mbeturinave komerciale ka një numër të udhëzimeve administrative, mirëpo për mbetjet më të vëllimshme ende nuk është arritur rregullimi për menaxhimin e detajuar të tyre sikurse në rastin e plastikës, letrës dhe kanoçes. “Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, komuna e Ferizajt dhe Fushë Kosovës kanë hartuar plane për menaxhimin e mbeturinave, mirëpo ato nuk kanë bërë një vlerësim se deri ku kanë arritur të

realizojnë këto plane. Si pasojë, nuk kanë informata se sa janë zbatuar çështjet që ndërlidhen me investime në impiante për trajtim të mbeturinave dhe për makinerinë e cila do të shërbente për ndarjen e mbeturinave në burim. Janë ndërtuar dy impiante me vlerë mbi 11 milion euro, por që vazhdojnë të mos jenë funksionale. Kjo përveç që pamundëson trajtimin e mbeturinave sipas kategorizimit të duhur, makineritë vazhdojnë të amortizohen pa u përdorur fare”, shkruan në raport. Në të njëjtën kohë theksohet se Kompanitë Regjionale të Mbeturinave gjatë grumbullimit nuk i ndajnë mbeturinat sipas katalogut shtetëror për mbeturina dhe një gjë e tillë nuk bëhet as nga Kompania për Menaxhimin e Deponive gjatë deponimit të tyre, derisa kategorizimi i mbeturinave për biznese kundrejt atyre të amvisërive bëhet vetëm për çështje të tarifës. “Mbrojtja e mjedisit është e rrezikuar pasi që deponitë sanitare dhe stacionet e transferit vazhdojnë të mos kenë leje të integruara. Edhe pse procesi i marrjes së lejes së integruar ka filluar nga viti 2012 dhe lëshohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ky proces deri në prill të vitit 2021 nuk ka përfunduar çka tregon se deponitë sanitare dhe stacionet e transferit vazhdojnë të deponojnë mbeturina pa i plotësuar kushtet për të mbrojtur tokën, ujin dhe ajrin. Përfundimet audituese tregojnë se çështjet lidhur me menaxhimin e mbeturinave komerciale kërkojnë përmirësime të menjëhershme”, nënvizohet në raport, ku janë adresuar edhe rekomandimet për institucionet përgjegjëse.²¹

²¹ ZKA, Raporti i auditimit të performancës “Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale”, linku: <https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/Mbledhja-trajtimi-dhe-asgjesimi-i-mbeturinave-komerciale.pdf>

KONKLUZIONET DHE 6.0 REKOMANDIMET

Për adresimin e çështjeve mjedisore natyrisht se Ministria e Mjedisit ka rol prijës, ndërkohë që sipas legjislacionit edhe Komunitetet kanë përgjegjësi për administrimin e mbrojtjes së mjedisit, duke bërë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre.

Autoritetet kosovare kanë pranuar se çështja e mjedisit në Kosovë trajtohet me prioritet të ulët, dhe janë zotuar se do të ketë ndryshim të qasjes në këtë aspekt. Pavarësisht hartimit dhe aprovimit të politikave publike për sektorët mjedisorë, niveli i zbatimit është i pamjaftueshëm, derisa aktivitet ilegale vazhdojnë të jenë në nivel shqetësues. Një gjë e tillë ka shtyrë edhe partnerët nga komunitetit ndërkombëtar që të kërkojnë angazhim më të madh nga niveli politik institucional për adresimin e degradimit të mjedisit. Në këtë aspekt, Kosova pavarësisht përpjekjeve për të harmonizuar legjislacionin e vet me atë të BE-së, përballet me shumë sfida sa i përket zbatimit praktik të tyre.

Marrë parasysh këto, edhe pyetjet e adresuara nga EC Ma Ndryshe lidhur me inspektimet komunale në 7 Komunitetet e Kosovës, që njihen si qendra rajonale (Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjiilan, Gjakovë dhe Mitrovicë e Jugut) dhe përgjigjet e pranuar ofrojnë një pasqyrë për nivelin e ulët të inspektimeve mjedisore, si dhe mungesë të llogaridhënies e nivelit të transparencës karshi

shoqërisë civile në përgjithësi. Për periudhën kohore janar – qershor 2021 në gjithsejtë 7 Komunitetet më të mëdha të Kosovës janë shqiptuar 252 gjopa mandatore, si dhe janë adresuar 35 kërkesa në Gjykatat përkatëse nga ana e Inspektorëve komunal mjedisorë. Në anën tjetër, numri i inspektorëve mjedisorë mbetet mjaft i ulët në krahasim me numrin e madh të problemeve mjedisore, që po ndikojnë në degradimin e mjedisit.

Prandaj rekomandohet që organet shtetërore të Kosovës, përfshirë komunitetet që të intensifikojnë përpjekjet drejt zbatimit të dispozitave ligjore kundër degradimit mjedisor dhe krimeve në këtë fushë, në mënyrë që të shtohet efikasiteti në mbrojtjen e mjedisit.

Komunitetet respektive rekomandohen që të ndërmarrin veprime konkrete për shtimin e mbikëqyrjes inspektive për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim të parandalimit të degradimit të mëtejshëm që manifestohet me pasoja të shumta negative.

Në mungesë të dërgimit të raporteve vjetore në MMPHI si dhe me mos publikimin e tyre në ueb faqet e Komunitetit, publiku privohet nga e drejta për t'u njoftuar dhe për të kërkuar përgjegjësi lidhur me rastet e ndotjes së mjedisit, dëmtimit të mjedisit apo degradimit të mjedisit. Prandaj autoritetet publike rekomandohen që të përmirësojnë tutje bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet tyre për

zbatimin e masave sikurse edhe mbikëqyrjen inspektuese me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, në mënyrë që të minimizohet rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut sikurse edhe të krijesave tjera, si dhe të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e resurseve natyrore, paralelisht me nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit.

Komunat rekomandohen që të angazhohen me seriozitet më të madh për të përmbushur obligimet drejt përmirësimit të cilësisë së ajrit, duke filluar me hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për Cilësinë e Ajrit.

Legjislacioni në fuqi në Kosovë për mbeturina ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre. Gjendja aktuale tregon se ka ende punë për të bërë nga të gjitha institucionet përgjegjëse dhe vet shoqëria për të arritur standardet evropiane të menaxhimit të mbeturinave, ashtu që sasia e mbeturinave për deponim të zvogëlohet në minimum dhe deponimi të bëhet në mënyrë të sigurt, pastaj që mbeturinat të jenë sa më pak të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe që mbeturinat të futen në treg për përfitim ekonomik, sidomos nga procesi i riciklimit, apo të kthehen në mjedis në formë të dobishme (p.sh. kompostim) ose që mbeturinat të jenë bërë të padëmshme. Prandaj rekomandohet rritja e mbulimit të grumbullimit të mbeturinave, veçanërisht me futjen e ndarjes së mbeturinave dhe riciklimin e tyre, futjen e masave të ekonomisë qarkore për të zvogëluar

mbeturinat, si dhe adresimin e çështjes së deponive të paligjshme me mobilizimin e komunitetit për arritjen e rezultateve pozitive në këtë drejtim.

Në anën tjetër qytetarët duhet që të bëjnë përpjekje maksimale për të mbajtur në minimum krijimin e mbeturinave, duke bërë gjithçka që është e mundur në mënyrë të arsyeshme për të ripërdorur, ricikluar ose rikuperuar; paralelisht me kujdesin që mbeturinat mos të hidhen në mënyrë të paligjshme nga transportuesit, sikurse edhe raportimin tek autoritetet për parregullsitë e kësaj natyre.

Gjithashtu duhet shtuar se disa nga çështjet kryesore në Kosovë sa i përket mjedisit janë hulumtimet e mangëta që zhvillohen për burimet e ndotjes. Organet shtetërore raportojnë në kohë reale për ndotjen e ajrit, mirëpo nuk ka analiza të mjaftueshme për ndotjen e dheut e poashtu edhe të ujërave sipërfaqësore. Për ujërat nëntokësore mungojnë hulumtimet qoftë për potencialet sasiorë si dhe për cilësinë e tyre. Prandaj hulumtimi dhe monitorimi i integruar i burimeve të ndotjes duke u bazuar në ciklin e ndotjes për pjesë të ndryshme mjedisore dhe raportimi i zbërthyer për nivele lokale do të ju mundësonte komunave të marrin vendime dhe masa të mirë informuara me ç'rast zbutja e ndikimeve negative nga ndotja do të bëhej në burimet e tyre.

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: **1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1.** Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithë- përfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
- 2.** Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
- 3.** Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
- 4.** Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.



www.ecmandryshe.org